



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Zyra Ekzekutive – Komisioni i Pavarur i Mediave

RAPORT MONITORIMI

OSHMA-TË GJATË FUSHATËS SË RAUNDIT TË II-të TË ZGJEDHJEVE PËR KRYETARË
TË KOMUNAVE

2021

Periudha e monitorimit 8 – 14 nëntor 2021

Prishtinë

Përmbajtja

I. Përmbledhje Ekzekutive	4
II. Baza Ligjore	5
III. Metodologjia dhe realizimi	5
IV. Gjetjet nga monitorimi.....	7
V. Shkeljet e gjetura	10
VI. Veprimet e KPM-së lidhur me Zgjedhjet.....	12
VII. Ankesat	14
VIII. Hapësira e ofruar për SCP-të.....	14
1. OSHMA-të me mbulim tokësor nacional	19
RTK1	19
KTV	29
TV21.....	39
2. OSHMA-të me mbulim tokësor lokal/regjional	46
TV DUKAGJINI	46
SYRI VISION.....	54
TV BESA.....	56
TV PRIZRENI.....	57
TV MOST.....	59
3. OSHMA-të që operojnë përmes OSH-ve	61
RTK2	61
KLAN KOSOVA	69
TE7	78
Kanal 10.....	84
ATV	92
IX. Periudha e heshtjes zgjedhore	102
X. Përfaqësimi gjinor gjatë zgjedhjeve.....	102
XI. Sfidat dhe vështirësitë gjatë monitorimit të pajtueshmërisë së të licencuarve të KPM-së	103
XII. Konkluzione dhe rekomandime	103

AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT

- KPM - Komisioni i Pavarur i Mediave
- KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- DMA - Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së
- SCP - Subjekt i Certifikuar Politik
- OSHMA - Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel
- OSH - Operator i Shpërndarjes

I. Përmbledhje Ekzekutive

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), duke qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës¹, që vlen edhe për Zgjedhjet Lokale², ka bërë monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuele (OSHMA) që kanë mbuluar fushatën e zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës.

Zgjedhjet Lokale, për kuvende komunale dhe kryetar të komunave, janë mbajtur më 17 tetor 2021.

Ndërsa, fushata zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave ka zgjatur nga data 8 deri më 12 nëntor 2021, ndërsa zgjedhjet janë mbajtur më 14 nëntor 2021.

Zgjedhjet janë zhvilluar në njëzet e një (21) komuna të Republikës së Kosovës, në të cilat: LVV ka garuar në dymbëdhjetë (12) komuna, LDK në nëntë (9) komuna, PDK në tetë (8) komuna, AAK në pesë (5) komuna, ndërsa në nga një (1) komunë kanë garuar PSD, Srpska Lista, NISMA, GI SNS, KDTP, KATP, IQ për Obiliq dhe Demokratët për Drenasin. Nga katërdhjetë e dy (42) kandidatë për kryetarë të komunave, vetëm një (1) ka qenë e gjinisë femërore.

Qëllimi i monitorimit, për periudhën 8 deri më 14 nëntor 2021, ishte vlerësimi i performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, të titulluar “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”, si dhe Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së. Ky raport është realizuar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA) i Zyrës Ekzekutive dhe prezanton të gjeturat nga monitorimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe periudhës së heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.

Në monitorim janë përfshirë njëzet e dy (22) OSHMA, prej të cilëve:

- Tre (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Katërmëdhjetë (14) me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Liria, TV Festina, TV Prizreni, TV Besa, TV Mitrovica, TV Puls, TV Tema, TV Vali, TV Mir, TV Dukagjini, TV Syri, TV Herc, TV Most, TV Iliria); dhe
- Pesë (5) me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Kanal 10, ATV, Klan Kosova dhe TE7).

Dy OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Zoom dhe TV Opinion) nuk janë të përfshira në monitorim, pasi që nuk kanë qenë në transmetim për shkaqe teknike.

Gjatë procesit të monitorimit, në fokus ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, pikat reklamuese politike, kronikat zgjedhore dhe intervistat e debatet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00. Zyrtarët e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës (DMA) gjatë periudhës monitoruese kanë vlerësuar: paanshmërinë në raportim, hapësirën e ofruar për SCP-të, gjuhën e përdorur dhe, në përgjithësi, pajtueshmërinë me

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2549>

Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve³ dhe aktet tjera nënligjore përkatëse të KPM-së.

Nga të gjeturat e monitorimit rezulton se prezantimi i fushatës për zgjedhjet nga OSHMA-të, ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtim me dispozitat për media në Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuele⁴.

Gjatë periudhës zgjedhore në KPM nuk është adresuar asnjë ankesë, për dallim nga raundi i parë gjatë së cilit ishin adresuar katër (4) ankesa.

II. Baza Ligjore

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”. Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve (i publikuar edhe në ueb faqen e KPM-së⁵), i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje, e në të cilin janë përfshirë edhe dispozita ligjore të parapara në aktet nënligjore të KPM-së, përkatësisht në Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/035 dhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuele KPM 2017/07⁶.

Sipas nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje, KPM siguron që të licencuarit mirëmbajnë ditarë për të regjistruar kohën e emetimit dhe ekspozimeve tjera në media, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilin SCP. Për këtë qëllim, KPM u ka dërguar të licencuarve edhe format e ditarëve me dhe pa pagesë si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre, të cilat janë në dispozicion edhe në ueb-faqen e KPM-së⁷. Gjithashtu, KPM ka kërkuar nga OSHMA-të të njoftojnë nëse do të mbulojnë periudhën e fushatës zgjedhore gjatë zgjedhjeve për kryetarë të komunave.

III. Metodologjia dhe realizimi

Metodologjia e përdorur gjatë monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuele është bazuar në analizë sasiore dhe cilësore të përmbajtjeve programore të transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00, me theks të veçantë edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore, pikat reklamuese politike, intervistat dhe debatet.

Metodologjia e monitorimit ka konsistuar në regjistrimin e programeve, kategorizimin e tyre, si dhe matjet e kohës/hapësirës për sekondë të dedikuara për secilin SCP. Po ashtu, të dhëna janë nxjerrë edhe lidhur me mbulimin sasior të kandidatëve të SCP-ve sipas komunave përkatëse. Për këtë qëllim janë futur të dhëna në tabelat e dizajnuara paraprakisht, është bërë vlerësimi i

³ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Udh%C3%ABzues%20i%20KPM-s%C3%AB%20p%C3%ABr%20sjelljen%20e%20mediave%20gjat%C3%AB%20zgjedhjeve.pdf>

⁴ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1476189555.8908.pdf>

⁵ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3420

⁶ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1514284325.0124.pdf>

⁷ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3420

prezantimit të fushatës nëse ka qenë pozitiv, negativ apo neutral, përpunimi dhe analiza e të dhënave të fituara dhe në fund hartimi i raportit final lidhur me mbulimin medial të fushatës zgjedhore. Nxjerrjen e këtyre të dhënave e mundësoi sistemi i monitorimit të cilin e posedon KPM, përmes të cilit bëhet pranimi, incizimi dhe arkivimi i programeve të transmetuara të OSHMA-ve. Ndërsa, në rastet kur për shkaqe teknike nuk ka pasur regjistrim të ndonjë përmbajtje të caktuar, DMA ka kërkuar arkivën nga OSHMA-të. Matja e hapësirës së dedikuar SCP-ve dhe hapësirës së kandidatëve sipas komunave, është bërë duke llogaritur kohën në sekonda në lajme, kronika zgjedhore, debate dhe intervista, për periudhën prej datës 08 deri më 12 nëntor 2021, nga ora 16:00 deri 24:00. Bazuar në këto llogaritje, janë dhënë tabelat përkatëse të pasqyruara në këtë raport.

Analizat cilësore janë bërë për të vlerësuar nëse:

- OSHMA-të kanë raportuar në mënyrë të drejtë, korrekte, objektive dhe të paanshme;
- OSHMA-të kanë ofruar mundësi për promovimin e platformave politike të kandidatëve për kryetarë/SCP-ve në garë;
- OSHMA-të kanë ofruar qasje të njëjtë për kandidatët për kryetarë/SCP-të në debate/intervista, pyetje të njëjta, mundësi për replikë në emisione debatuese, renditje të aktiviteteve zgjedhore në lajme dhe kronika zgjedhore (renditja me rotacion duke mos favorizuar prezantimin e aktiviteteve të kandidatëve për kryetarë/SCP-ve me renditje të njëjtë për çdo ditë të fushatës); dhe
- OSHMA-të kanë vepruar në pajtueshmëri me heshtjen zgjedhore dhe dispozitat tjera të Ligjit për Zgjedhje.

Po ashtu, gjatë analizës është bërë edhe vlerësimi për mënyrën e prezantimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe standardet profesionale të gazetarisë (nëse ka pasur nxitje të urrejtjes, gjuhë të papërshtatshme, denigruese, fyerje, shpifje apo shkelje të dispozitave tjera të dhëna në Kodin e Etikës) si dhe pajtueshmërinë me Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

Kohëzgjatja dhe të gjeturat në këtë raport përfshijnë periudhën e monitorimit nga data 8 deri më 14 nëntor 2021, përfshirë periudhën e fushatës zgjedhore dhe periudhën e heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve.

Në monitorim janë përfshirë njëzet e dy (22) ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, prej të cilëve:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Katërmbëdhjetë (14) me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Liria, TV Festina, TV Prizreni, TV Besa, TV Mitrovica, TV Puls, TV Tema, TV Vali, TV Mir, TV Dukagjini, TV Syri, TV Herc, TV Most, TV Iliria); dhe

- Pesë (5) me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Kanal 10, ATV, Klan Kosova dhe TE7).

Dy OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Zoom dhe TV Opinion), të cilët për shkaqe teknike nuk kanë qenë në transmetim, nuk janë përfshirë në këtë monitorim.

IV. Gjetjet nga monitorimi

Gjatë fushatës zgjedhore, OSHMA-të kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht Kreun VIII-të këtij Ligji, që vlen edhe për zgjedhjet lokale, përkatësisht zgjedhjet për kryetarë të komunave. Në përgjithësi, përmes përmbajtjeve programore, OSHMA-të kanë ofruar përfaqësim të drejtë dhe të paanshëm, në kuptimin e hapësirës së dhënë kandidatëve/SCP-ve, ku kryesisht janë mbuluar kandidatët/SCP-të që kanë zhvilluar më tepër aktivitetet zgjedhore.

Ndërsa, raportimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës ishte kryesisht neutral dhe gjuha e përdorur gjatë kësaj fushate ka qenë në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale.

Sa i përket reklamimit politik, është gjetur se janë transmetuar pika reklamuese politike në kohëzgjatje më tepër se dy (2) minuta në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhje, në OSHMA-të:

- KTV – tri (3) pika reklamuese politike të SCP-së PDK, të transmetuara më 11 dhe 12 nëntor 2021.
- Kanal 10 – dy (2) pika reklamuese politike të SCP-së PDK, të transmetuara më 11 nëntor 2021 dhe një pikë reklamuese politike më 12 nëntor 2021.

Po ashtu, shkelje është vërejtur edhe sa i përket mos-identifikimit të duhur të pikave politike reklamuese, siç përcaktohet në nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhje dhe Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve. Këto pika reklamuese politike të SCP-së PDK janë vërejtur në Kanal 10 (një rast më 10 nëntor 2021) dhe TE7 (më 10 dhe 11 nëntor 2021).

Sa i përket Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, për dallim nga raundi i parë gjatë së cilit janë vërejtur shkelje sa i përket prezencës së fëmijëve në pika politike reklamuese dhe gjuhës së përdorur, në këtë fushatë zgjedhore OSHMA-të kanë vepruar në pajtueshmëri.

Ndërsa, në lidhje me Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale, është vërejtur se edhe gjatë kësaj periudhe janë bërë shkelje gjatë transmetimit të programeve të çështjeve aktuale (programe dhe debate politike), në të cilat ka pasur reklamim me ekran të ndarë, kanë qenë të sponsorizuara si dhe ka pasur vendosje të produktit.

Reklamimi me ekran të ndarë, në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1, të kësaj Rregulloreje, janë vërejtur në OSHMA-të:

Klan Kosova

- Emisioni “Rubikon”

- Emisioni “Info Magazine”

TV Dukagjini

- Emisioni “Debat Plus”

Kanal 10

- Emisioni “Prime Time”
- Emisioni “Politiko”

TE7

- Emisioni “Presing”
- Emisioni “DPT te Fidani”

Në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 3, të kësaj Rregulloreje, shkelje janë vërejtur në:

Klan Kosova

- Emisioni “Rubikon”

TV Dukagjini

- Emisioni “Debat Plus”

Kanal 10

- Emisioni “Prime Time”
- Emisioni “Politiko”

TE7

- Emisioni “Presing”
- Emisioni “DPT te Fidani”

Ndërsa, vendosje e produktit, në kundërshtim me nenin 15, është vërejtur në:

KTV

- Emisioni “Interaktiv”
- Emisioni “60 Minuta”

Klan Kosova

- Emisioni “Rubikon”
- Emisioni “Edicioni Special”
- Emisioni “Info Magazine”

TV Dukagjini

- Emisioni “Debat Plus”

Kanal 10

- Emisioni “Prime Time”
- Emisioni “Politiko”

TE7

- Emisioni “Presing”
- Emisioni “DPT te Fidani”

Ndërsa, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, që ka filluar njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendvotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve, me përjashtim të disa rasteve, OSHMA-të kanë vepruar në pajtim me nenin 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme. Gjatë ditës së votimit, në përgjithësi OSHMA-të kanë raportuar rreth mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, përfshirë këtu mbulimin e konferencave të KQZ-së, intervista me përfaqësues të qendrave të votimit, qytetarë etj..

Shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhje janë vërejtur në katër (4) OSHMA: Kanal 10, Klan Kosova, KTV dhe TE7.

Rastet e shkeljes së heshtjes zgjedhore, janë vërejtur në:

Kanal 10 (14 nëntor 2021)

- Gjatë transmetimit të intervistave me qytetarë në Komunën e Istogut, ku dy të intervistuar tregojnë preferencat e tyre politike duke përdorur shprehjet si *“besoj në Bekën”* (duke iu referuar kandidatit për kryetar nga SCP AAK, z. Bekë Berisha). Moderatorin në studio ka theksuar se distancohen nga çfarëdo deklarate e cila mund të ndikojë tek votuesit e që realizohen drejtpërdrejt dhe ka kërkuar falje për rastin duke arsyetuar se deklaratimet e drejtpërdrejta janë vështirë të menaxhueshme.
- Gjatë transmetimit të deklaratës së kandidatit për kryetar të Podujevës të SCP LDK, z. Ekrem Hyseni, i cili në mes tjerash thekson: *“...ne presim një fitore bindëse, e cila mendoj është në vullnet të qytetarëve, ka pas entuziazëm, ka pas përkrahje dhe uroj që kjo përkrahje të materializohet dhe e di që do të jetë një rezultat i mirë. Sido që të jetë ftoj të gjithë qytetarët që të votojnë...”*.

Klan Kosova (14 nëntor 2021)

- Gjatë transmetimit të intervistave me qytetarë, me ç’rast duke i përgjigjur pyetjes së gazetares se *“a ishte lehtë të votohet?”*, një nga të intervistuarit thekson *“...lehtë, qaty LDK-së”*. Lidhur me këtë, moderatorja në studio ka kërkuar që të ndalet menjëherë intervista.
- Gjatë transmetimit të deklaratës së kandidatit për kryetar të Fushë Kosovës nga SCP LDK, z. Burim Berisha, i cili në mes tjerash thekson: *“Unë do të shënojë një fitore. Besoj qytetarët do të vendosin”*.

- Gjatë transmetimit të konferencës së SCP LVV, dega në Prizren, me ç'rast përfaqësuesi i këtij subjekti, duke iu referuar të dhënave nga vëzhguesit e tyre, përmend disa vendvotime në të cilat thekson se ka pasur grumbullime të personave të paautorizuar, si dhe përmend se pas raportimeve të tyre në disa raste ka reaguar Policia e Kosovës. Në mes tjerash, theksohet se (duke iu referuar këtyre personave) *“janë persona të cilët janë të njohur nga qytetarët dhe janë lobues por edhe financues të partisë kundërshtare”*.
- Gjatë transmetimit të konferencave të SCP-ve: AAK, LDK dhe PDK, gjatë së cilave janë identifikuar simbolet partiake të tyre.

KTV (14 nëntor 2021)

- Gjatë transmetimit të një materiali të titulluar *“kandidatët dhe rëndësia që u dhanë veshjeve në fushatën e zgjedhjeve”*, në mes tjerash shfaqen pamje kur një deputet i SCP PDK në një seancë të Kuvendit kishte veshur kostumin e tij, në të cilin shihet numri 177. Numri 177 ka qenë numri garues i SCP PDK në këto zgjedhje lokale.

TE7 (14 nëntor 2021)

- Gjatë transmetimit të deklaratës së kandidatit për kryetar të Fushë Kosovës nga SCP LDK, z. Burim Berisha, i cili në mes tjerash thekson: *“Unë do të shënojë një fitore. Besoj qytetarët do të vendosin”*. Në këtë rast, nuk ka pasur ndërhyrje nga ana e gazetarit dhe se kandidati ka përfunduar tërë deklaratën e tij. Kurse, moderatorët në studio reagojnë lidhur me këtë deklaratë, duke theksuar se do ta ndërprejnë deklaratën e tij, për shkak se kjo përbënë shkelje të heshtjes zgjedhore.

Pas shkresave së dërguara nga Departamenti Ligjor i KPM-së, në këto OSHMA nuk janë vërejtur shkelje tjera sa i përket heshtjes zgjedhore.

V. Shkeljet e gjetura

Nga monitorimi i OSHMA-ve që kanë mbuluar fushatën zgjedhore është vërejtur se, me përjashtim të disa rasteve, OSHMA-të kanë vepruar në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuale.

Shkeljet e evidentuara kishin të bëjnë me:

- Pikat reklamuese politike, përkatësisht kohëzgjatjes së tyre më tepër se dy (2) minuta dhe mos identifikimit të duhur të tyre;
- Reklamimin me ekran të ndarë, sponsorizimin dhe vendosjen e produkteve në programe për çështje aktuale; dhe
- Shkeljen e periudhës së heshtjes zgjedhore.

Sa i përket pikave reklamuese politike, është vërejtur se gjatë periudhës monitoruese janë transmetuar pika reklamuese politike më të gjata se dy (2) minuta.

Në bazë të nenit 49, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhje përcaktohet që: *“Pikat reklamuese politike nuk janë më të gjata se dy (2) minuta (120 sekonda)”*.

Po ashtu, shkelje janë vërejtur edhe sa i përket mos-identifikimit të duhur të pikave reklamuese politike, përkatësisht identifikimi nuk është bërë gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre.

Në bazë të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L-073 përcaktohet që: *“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të”*.

Ndërsa, në Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve, përcaktohet se: *“Pavarësisht nëse reklamimi politik emitohet në kohën e blerë apo si pjesë e kohës pa pagesë të cilën ofruesi i shërbimit medial audiovizuel ua ofron subjekteve politike, teksti duhet të thotë se është “reklamim politik i sponsoruar nga [emri i partisë, organizatës, ose individi i cili ka paguar për kohën apo ka kërkuar pjesën e kohës pa pagesë].”*

Televizioni: Reklamimi politik duhet të emërtohet si i tillë duke përdorur një tekst të fiksuar apo lëvizës në fund të ekranit, i cili është i dukshëm gjatë gjithë reklamës politike”.

Sa i përket Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, shkelje janë vërejtur sa i përket formave të komunikimeve komerciale audiovizuale si: reklamim me ekran të ndarë, sponsorizim dhe vendosje e produktit në programe të çështjeve aktuale, përkatësisht debateve zgjedhore.

Sipas paragrafit 1 të nenit 12 të kësaj Rregulloreje, thuhet se: *“Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t’ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshoppingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë.”*

Në bazë të nenit 31, paragrafi 4, të Ligjit për KPM-në, përcaktohet që: *“Programet e lajmeve dhe ngjarjeve aktuale nuk do të sponsorizohen”*.

Ndërsa, sipas nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale theksohet se: *“Programet e lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale nuk do të sponsorizohen”*.

Sipas nenit 32, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, përcaktohet që: *“Ndalohej vendosja e produktit”*.

Ndërsa, sipas paragrafit 1 të nenit 15 të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale theksohet që: *“Vendosja e produkteve do të ndalohej”*.

Sipas nenit 32, paragrafi 2.1, të Ligjit për KPM-në dhe nenit 15, paragrafit 2, nën-paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, vendosja e produktit lejohet në programe të caktuara, duke përjashtuar programet informative dhe ato të çështjeve aktuale.

Ndërsa, në periudhën e heshtjes zgjedhore, janë identifikuar kryesisht raste të shkeljeve gjatë:

- transmetimeve të deklaratave të kandidatëve për kryetar të komunave, për të cilat raste për shkak se janë transmetuar drejtpërdrejt disa nga të licencuarit kanë ofruar sqarime;
- transmetimeve të drejtpërdrejta të intervistave me qytetarë, ku disa prej të cilëve janë deklaruar për kandidatin për të cilët kanë preferenca, dhe në këto raste janë ndërmarr veprime nga OSHMA-të për të evituar shkeljet;

- transmetimeve të drejtpërdrejta të konferencave për media të SCP-ve, për shkak të gjuhës së përdorur apo shfaqjes së simboleve partiake.

Në shumicën e këtyre rasteve, OSHMA-të kanë ndërmarr veprime sa i përket shkeljeve, përmes ndërprerjes së deklaratave, tërheqjes së vërejtjes për të intervistuarit për të pasur kujdes sa i përket heshtjes zgjedhore, si dhe ofrimit të sqarimeve rreth këtyre shkeljeve.

Sipas nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje përcaktohet se: *“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon 24 orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve”*.

Neni 53 i Ligjit për Zgjedhje përcakton që: *“Komisioni i Pavarur për Media siguron se mediat mirëmbajnë një ditar për të regjistruar kohën e emetimit, dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti. Ditari i vlerëson të gjithë treguesit relevant të ekspozimeve, ndaras për secilin subjekt politik, sipas mënyrës së përcaktuar me rregullat e KPM-së”*.

Sa i përket pajtueshmërisë së OSHMA-ve me nenin 53 të Ligjit për Zgjedhje, KPM pas rishikimit të të dhënave të ofruara, do të vlerësojë pajtueshmërinë e të licencuarve me dispozitën ligjore të përcaktuar në këtë Ligj.

VI. Veprimet e KPM-së lidhur me Zgjedhjet

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, KPM para fillimit të fushatës zgjedhore, më 1 nëntor 2021⁸, ka njoftuar të licencuarit për mbajtjen e fushatës zgjedhore si dhe ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve. Po ashtu, njoftimi për zgjedhjet si dhe materiali zgjedhor, përfshirë këtu Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve, Format e Ditarëve me dhe pa pagesë, janë publikuar edhe në ueb-faqen e KPM-së.

Përmes një komunikate për medie, më 12 nëntor⁹ dhe 14 nëntor 2021¹⁰, KPM-ja ka kërkuar nga të licencuarit që të respektohet obligimi ligjor i paraparë sipas nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhje, që ka të bëjë me heshtjen zgjedhore.

Veprimet ligjore lidhur me shkeljet e OSHMA-ve gjatë procesit të zgjedhjeve

Lidhur me shkeljet e OSHMA-ve gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, janë ndërmarr veprime ligjore si në vijim:

- Për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale:

- 1. TV Dukagjini:** Njoftim për Shkelje më datë 10 nëntor 2021, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, si dhe nenit 15 (Reklamim me ekran të ndarë, sponsorizim dhe vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).

⁸ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3420

⁹ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3429

¹⁰ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3430

2. **Klan Kosova:** Njoftim për Shkelje më datë 10 nëntor 2021, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, si dhe nenit 15 (Reklamim me ekran të ndarë, sponzorizim dhe vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).
3. **TE 7:** Njoftim për Shkelje më datë 10 nëntor 2021, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, si dhe nenit 15 (Reklamim me ekran të ndarë, sponzorizim dhe vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).
4. **KTV:** Njoftim për Shkelje më datë 10 nëntor 2021, për shkelje të nenit 15 (Vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).
5. **Kanal 10:** Njoftim për Shkelje më datë 10 nëntor 2021, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, si dhe nenit 15 (Reklamim me ekran të ndarë, sponzorizim dhe vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).

- Për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhje:

1. **Kanal 10:** Shkresë më datë 14 nëntor 2021, për shkelje të heshtjes zgjedhore.
2. **Klan Kosova:** Shkresë më datë 14 nëntor 2021, për shkelje të heshtjes zgjedhore.
3. **KTV:** Shkresë më datë 14 nëntor 2021, për shkelje të heshtjes zgjedhore.
4. **TE7:** Shkresë më datë 14 nëntor 2021, për shkelje të heshtjes zgjedhore.

Vendimet e KPM-së lidhur me shkeljet e OSHMA-ve gjatë procesit të zgjedhjeve

Lidhur me shkeljet e OSHMA-ve gjatë procesit të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, KPM ka marr këto vendime:

Më 11 nëntor 2021¹¹

TV Dukagjini: Masë sanksionuese me gjobë në shumën prej tremijë (3,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07;

TE7: Masë sanksionuese me gjobë në shumën prej katërmijë (4,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07 dhe Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;

Klan Kosova: Masë sanksionuese me gjobë në shumën prej tremijë (3,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07;

¹¹ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3428

Kanal 10: Masë sanksionuese me gjobë në shumën prej katërmijë (4,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07 dhe Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;

KTV: Masë sanksionuese me gjobë në shumën prej tremijë (3,000) euro për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07;

Kanal 10: Masë sanksionuese Vërejtje për shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, lidhur me Ankesën nga Kushtrim Brahimaj, ankesë e parashtruar gjatë raundit të parë të zgjedhjeve.

VII. Ankesat

Gjatë periudhës së raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave në Republikën e Kosovës, në KPM nuk është parashtruar asnjë ankesë.


VIII. Hapësira e ofruar për SCP-të

Të dhënat më poshtë, paraqesin mbulueshmërinë e OSHMA-të gjatë fushatës zgjedhore, sa i përket hapësirës së ofruar për SCP-të në përgjithësi dhe hapësirës së ofruar për kandidatët e SCP-ve sipas komunave përkatëse, nga data 8 deri më 12 nëntor 2021, vetëm për periudhën kohore nga ora 16:00-24:00 gjatë së cilës është bërë monitorimi.

Hapësira është llogaritur edhe në rastet kur në këto OSHMA janë ritransmetuar programe të lajmeve nga jashtë apo debate të bashkëprodhuara. Po ashtu, në rastet kur nga udhëheqësit e programit është njoftuar se kandidati për kryetar i një SCP-je të caktuar nuk i është përgjigjur ftesës për pjesëmarrje në emision, në rastin e debateve apo intervistave, kjo kohë është llogaritur e shfrytëzuar për kandidatin/SCP-në e caktuar.


Hapësira e ofruar për të gjitha SCP në të gjitha komunat në lajmeve/kronika zgjedhore dhe debate/intervista						
OSHMA	Lajme (s)	Lajme (%)	Debate (s)	Debate (%)	Total (s)	Total (%)
TE7	2017	4.46	30050	8.83	32067	8.31
TV PRIZRENI	2660	5.88	3600	1.06	6260	1.62
TV Dukagjini	981	2.17	68079	19.99	69060	17.90
TV Syri Vision	1715	3.79		0.00	1715	0.44
RTK 2	1756	3.88	10532	3.09	12288	3.19
TV MOST	116	0.26		0.00	116	0.03
KLAN KOSOVA	4823	10.66	53098	15.59	57921	15.02
KANAL 10	2331	5.15	11052	3.25	13383	3.47
RTK1	12666	27.99	75809	22.26	88475	22.94
RTV21	2302	5.09	19697	5.78	21999	5.70
ATV	1991	4.40	37452	11.00	39443	10.23
KTV	3913	8.65	31124	9.14	35037	9.08
TV Besa	7979	17.63	0	0.00	7979	2.07
TOTAL:	45250	100	340493	100	385743	100

Ediciome e lajmeve/kronika




- TE7
- TV MOST
- ATV
- TV PRIZRENI
- KLAN KOSOVA
- KTV
- TV Dukagjini
- KANAL 10
- TV Besa
- TV Syri Vision
- RTK1
- RTK 2
- RTV21


Debate/kronika



- TE7
- TV MOST
- ATV
- TV PRIZRENI
- KLAN KOSOVA
- KTV
- TV Dukagjini
- KANAL 10
- TV Besa
- TV Syri Vision
- RTK1
- RTK 2
- RTV21

Hapësira e ofruar nga të gjitha OSHMA-të për kandidatët sipas SCP-ve përkatëse në edicione të lajmeve/kronika zgjedhore dhe debate/intervista				
SCP-ja	Lajme (s)	Lajme (%)	Deb./Int. (s)	Deb./Int. (%)
LVV	16384	36.21	135325	39.74
LDK	6919	15.29	87759	25.77
PDK	13455	29.73	64481	18.94
AAK	5474	12.10	23279	6.84
Demokratët për Drenasin	976	2.16	9499	2.79
PSD	562	1.24	1929	0.57
Iniciativa Qytetare për Obiliq	512	1.13	5802	1.70
NISMA	761	1.68	1887	0.55
KDTP			1066	0.31
KATP			1066	0.31
Sepska Lista	91	0.20	3600	1.06
GI SNS	116	0.26	4800	1.41
TOTAL:	45250	100.00	340493	100







Hapësira e ofruara nga të gjitha OSHMA-të për komunat përkatëse në edicionet e lajmeve/kronikave zgjedhore dhe debate/intervista				
Komuna	Lajme/Kronika (s)	Lajme/Kronika (%)	Debate/intervista (s)	Debate/intervista (%)
Prishtinë	5651	12.49	54905	16.13
Prizren	15160	33.50	47000	13.80
Gjakovë	2955	6.53	24948	7.33
Glllogoc	1711	3.78	15663	4.60
Gjilan	1446	3.20	37844	11.11
Dragash	1062	2.35	12272	3.60
Istog	2112	4.67	384	0.11
Kacanik	1506	3.33	16455	4.83
Klinë	1207	2.67	9756	2.87
Fushë Kosovë	338	0.75	4846	1.42
Kamenicë	687	1.52	3858	1.13
Obiliq	573	1.27	11604	3.41
Rahovec	605	1.34	14034	4.12
Podujevë	2152	4.76	16601	4.88
Shtime	1079	2.38	9710	2.85
Viti	1001	2.21	29788	8.75
Vushtrri	2132	4.71	12262	3.60
Malishevë	2091	4.62	5077	1.49
Junik	1575	3.48	2954	0.87

Mamushë			2132	0.63
Klllokot	207	0.46	8400	2.47
TOTAL:	45250	100.00	340493	100

Edicionet e lajmeve/kronika



Debate/intervista



